



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 05.05.2021,  
duke filluar në orën 13:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Egzon Azemi, Fadil Gashi, Sami Boroci dhe Genc Sherifi.

**Mungoi:** Vala Peshku dhe Blerand Stavileci.

**Në mbledhje të pranishëm ishin edhe:** Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave dhe Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Egzon Azemi theksoi se nuk është e përfshirë në rend dite pika "Propozimvendimi për subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e transportit publik urban". Njëherësh ai kërkoi që të bëhet një diskutim, apo të jepet një informatë më e detajomë për skandalet e publikuara në medie për ndërmarrjen "Trafiku Urban", qoftë dikush nga aksionarët ose ekzekutivi, të na jepen sqarime për këtë skandal. Kryesuesi kërkoi që t'i sugjerohet Komitetit, që brenda mundësive të përgatitet për seancën e Kuvendit propozimvendimi për subvencionimin e këtyre linjave.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua ky**

### **REND DITE:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Raporti financiar buxhetor për periudhën 1 janar - 31 mars 2021 (TM 1);**

3. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Vahide Imer Gashit, Vjollca Emrush Gashi - Hoxha dhe Ramiz Faik Gashit;
5. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të NNT "Ndërtimi -A";
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Uran Agim Dibranit;
7. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01. nr. 110 -21449, dt. 28.02.2013;
8. Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Prishtina Parking", SHA, Prishtinë;
9. Propozimrregullorja për definimin e parametrave urbanë - arkitektonikë të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese;
10. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID-19;
11. Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të futbollit, basketbollit dhe hendbollit;
12. Propozimvendimi për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës;
13. Propozimvendimi për subvencionimin e NPL "Sport Marketing", SHA, në Prishtinë;
14. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor për periudhën 1 janar - 31 mars 2021 (TM 1).

Agim Gashi kërkoi sqarime nga drejtoresha, që të shikohet tabela e shpenzimeve, ku gjithsej janë 945,945.15 €, e kur po i mbledhim në mënyrë vertikale po dalin 500 mijë €, është një mos përputhshmëri e madhe.



**Valbona Ahmeti - Makolli** theksoi se ndoshta është gabim teknik.

**Agim Gashi** tha se ju e keni pasqyruar vetëm planifikimin 85,792,836.50 € në buxhet, në shpenzime në TM 1 ka mundur me pasur edhe nga bartja mjeteve.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime, duke thënë se ende nuk është aprovuar bartja dhe jemi në pritje katër komuna.

**Agim Gashi** pyeti për projektet që kanë qenë në gjysmë, a kanë vazhduar këtë vit dhe a kryhen nga të hyrat e sivjetshme.

**Valbona Ahmeti - Makolli** tha po, nëse ka qenë projekti që vazhdon, nëse nuk vazhdon është në pritje.

**Sami Boroci** pyeti se në momentin që bëhet bartja a fillojnë me ekzekutim.

**Valbona Ahmeti - Makolli** theksoi se fillojmë menjëherë me ekzekutim, i kemi mbi 5mijë lëndë në pritje.

**Agim Gashi** tha se pasi që jemi te buxheti, për çështjen lidhur me rrugët në Hajvali dhe Butovc, a është rregulluar kontesti në mes dy drejtorive.

**Valbona Ahmeti - Makolli** dha sqarime lidhur me këtë çështje.

**Halim Halimi** theksoi se ne e kemi marrë materialin, d.m.th. raportin nga kryetari për periudhën TM 1, ku janë të paraqitura arkëtimet, shpenzimet me të dhëna mbi investimet dhe detyrimet për TM 1 të këtij viti. Ne e dimë se të hyrat e planifikuara për vitin 2021 janë 28,271,947.00 €, në këtë tremujor diku janë grumbulluar 8 milionë të hyra. Nëse e analizojmë deri në fund, besoj se tejkalohejt kjo shumë, mirëpo kur po bëhet planifikimi, për Komunën e Prishtinës planifikimi 28 milionë është pak. Kjo shumë e planifikimit po sillet rreth 5 - 6 vjet, 28 - 30 - 32! Prej atëherë Komuna është dashur të bëjë grumbullimin e të hyrave.

**Valbona Ahmeti - Makolli**, u shpreh se nuk mund ta rrisim, me tejkaluar po, por me rritur jo, të hyrat dhe për krejt i kemi tavanet. Çka tejkalohejt është tejkalim, por tavanet i kemi prej Ministrisë.

**Halim Halimi** shprehu mendimin se edhe Ministria duhet të mos caktojë tavane, se Komuna e Prishtinës duhet të grumbullojë të hyra buxhetore më shumë se ne që kemi planifikuar për vitin që shkoi.

Te shpenzimet, si gjithmonë shpenzimet për paga, mëditje, mallra, subvencione, ato po shkojnë lehtë dhe mirë, por gjithherë keq po janë investimet kapitale, harxhime shumë të vogla në infrastrukturë, ku kemi drejtori me zero shpenzime, çka është e pakuptueshme jo vetëm këtë vit, por edhe viteve paraprake është përcjellë e njëjta gjendje. Po ashtu, shqetësuese është për TM 1, detyrimet kontingjente, janë katër lëndë, ku vlera e tyre është 1,121,130.78 €.

**Kryesuesi** i sugjeroi drejtoreshës që të bëhet korigjimi i materialit në pjesën që e ceku zotëri Agimi.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua raporti financiar buxhetor për periudhën 1 janar - 31 mars 2021 (TM 1) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë.**



**Sami Boroci** pyeti se a është fjala për një shtesë për qasje.

**Egzon Azemi** theksoi se ka shumë shqetësime të qytetarëve lidhur me këtë lokacion, për shkak se është afër spitalit dhe është hapësira e vetme gjelbëruese në atë pjesë, kështu që është kërkesë e shumë qytetarëve që me diskutuar edhe një herë me Ambasadën e Gjermanisë, në mënyrë që të shihet mundësia e ndërrimit të lokacionit.

**Kryesuesi** bëri të ditur se kontrata është nënshkruar.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunale, Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë dhe të dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e katërt**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Vahide Imer Gashit, Vjollca Emrush Gashi - Hoxha dhe Ramiz Faik Gashit.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Vahide Imer Gashit, Vjollca Emrush Gashi - Hoxha dhe Ramiz Faik Gashit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e pestë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të NNT "Ndërtimi -A".

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të NNT "Ndërtimi -A" dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e gjashtë**

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Uran Agim Dibranit.

**Kryesuesi** konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Uran Agim Dibranit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e shtatë**

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, 01. nr. 110 -21449, dt. 28.02.2013.

**Agim Gashi** kërkoi sqarim lidhur me ndryshimin në këtë propozimvendim.



Osman Bllaca dha sqarime, duke thënë se ndryshimi në vendim është: "lirimi nga pagesa e ngarkesës vjetore për ndërmarrjet e shërbimeve hoteliere dhe motelet".

Egzon Azemi tha se meqë kjo është çështja e subvencionimit të gastronomeve, me pasur mundësi që subvencionimin me bërë me këtë fondin me grandin qeveritar, në mënyrë që me i shfrytëzuar këto mjete që po mbesin kot në fund e po na i marrin, d.m.th. me i shfrytëzuar grandet.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjopa komunale, 01. nr. 110 -21449, dt. 28.02.2013, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e tetë**

**Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Prishtina Parking", SHA, Prishtinë.**

Agim Gashi theksoi se kjo nuk është informatë, ne e kemi raportin, neve na e kanë dërguar raportin e jo informatën.

Kryesuesi theksoi se kjo është informatë lidhur me raportin. Komisioni i aksionarëve është dashur me u marrë me këtë raporte e me e sjellë informatën.

Agim Gashi tha se informata është dokument tjetër e raporti dokumente tjetër, të tjera standarde përdorën për të shkruar një informatë dhe tjera standarde përdoren për të shkruar një raport.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua informata lidhur me raportin vjetor të Komisionit të aksionarëve të NPL "Prishtina Parking", SHA, Prishtinë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e nëntë**

**Propozimrregullorja për definimin e parametrave urbanë - arkitektonikë të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese.**

Agim Gashi theksoi se te neni 5, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni thuhet: "nuk do të zbatohet nëse me dokumente të planifikimit hapësinor është përcaktuar ndryshe". Unë propozoj të jetë kështu: "paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni do të zbatohen në harmoni me dokumentet e planifikimit hapësinor". Ky do të ishte formulim i drejtë juridik dhe gjuhësor. Rregullorja formulohet në harmoni me Planin rregullues.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimrregullorja për definimin e parametrave urbanë - arkitektonikë të ndërtimeve dhe hapësirave gjelbëruese, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

#### **Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID -19.**



Jeta Rafuna kërkoi sqarime lidhur me lokacionin e caktuar.  
Kryesuesi dha sqarime, duke thënë se ajo gjendet në hyrje të QKUK-së.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimi n e lokacionit për vendosjen e obeliskut në shenjë mirënjohje për profesionistët shëndetësorë dhe në nderim të atyre që kanë ndërruar jetë nga virusi COVID -19, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të futbollit, basketbollit dhe hendbollit.**

Agim Gashi parashtrroi pyetje se sa mjete do të ndahen për hendbollin.

Osman Bllaca dha sqarime, duke thënë se 100 mijë euro kanë me iu ndarë futbollit, basketbollit dhe hendbollit.

Sami Boroci pyeti se si kanë me iu ndarë mjetet.

Osman Bllaca theksoi se ndarja do të jetë: 50 mijë euro, 30 mijë euro, 10 mijë euro dhe 10 mijë euro.

Agim Gashi pyeti kujt i ndahen 10 mijë euro dhe 10 mijë euro.

Osman Bllaca vetëm hendbollit iu ndahen edhe femrave edhe meshkujve.

Agim Gashi u shpreh se unë e përçolla diskriminimin, në vitin e kaluar 30 mijë euro iu kishin ndarë në hendboll meshkujve, ndërsa femrave më duket se nuk u janë ndarë hiq.

Jeta Rafuna pyeti se pse federatave të tjera nuk u janë ndarë, se kemi edhe klube të tjera, si p.sh. karate etj., por u janë ndarë vetëm futbollit, basketbollit dhe hendbollit.

Osman Bllaca sqaroi se vetëm klubeve të Prishtinës u ndahen mjetet, por jo federatave.

Jeta Rafuna pyeti se a kanë bërë kërkesa klubet, apo si po bëhet ndarja e mjeteve.

Agim Gashi theksoi se klubet i bëjnë kërkesat.

Kryesuesi theksoi se i kemi futur pikat që në ndërkohë me ardhur materialet, nëse nuk vjen materiali nuk i diskutojmë pikat.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për subvencionimin e klubeve të futbollit, basketbollit dhe hendbollit, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e dymbëdhjetë**

**Propozimvendimi për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës.**

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për subvencionimin e Shoqatës së Gastronomëve të Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e trembëdhjetë**

**Propozimvendimi për subvencionimin e NPL "Sport Markerting", SHA, në Prishtinë.**

**Sami Boroci** theksoi se nuk kemi material, nuk po e di vlerën, por është hera e dytë brenda një viti që po e subvencionojmë NPL "Sport Markerting". Kjo ndërmarrje e ka të pamundur funksionimin vetëm me një operator ekonomik, siç e ka tani Pishinën, plus është operator sezonal. Unë kam propozuar edhe më herët, por nuk është marrë askush me këtë çështje, që kësaj ndërmarrje ose duhet me i shtuar operatorë ekonomikë që gjenden të hyra, ose me e mbyllur. Nëse ju pajtoheni, kisha propozuar që të shihet mundësia që hapësirat reklamuese, terrenet sportive etj. që nuk i menaxhon Drejtoria e Sportit, me kaluar në NPL "Sport Markerting".

**Egzon Azemi** u shpreh i pajtimit me mendimin e Samiut, se para një viti dhe para dy viteve i kemi pasur të njëjtat, të njëjtat çështje i kemi përsëritur, kemi shprehur gatishmëri secili prej nesh për të marrë pjesë në ekipin, nëse krijohet nga Komuna, dhe kemi pasur premtime që do të krijohet komisioni, do të shqyrtohet mundësia se çka mundemi me bërë, me ndihmuar që me ia rritur fushë veprimtarinë, me bërë një plan, mirëpo asnjëherë nuk na kanë ftuar, as një veprim nuk është ndërmarrë në këtë drejtim.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për subvencionimin e NPL "Sport Markerting", SHA, në Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Të ndryshme**

**Sami Boroci** propozoi që të paguhen anëtarët e komiteteve jo obligative, në mënyrë që të funksionalizohen edhe këto komitetet tjera, e që në komunat tjera këto komitete paguhen.

**Osman Bllaca** sqaroi, duke thënë se mund të paguhen vetëm në formë mëditje, e jo në tjetër formë.

*Mbledhja përfundoi në orën 13:55.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit  
Agim Kulefa**

